

Mesme/Srednja Klina kanë mbetur vetëm Dibrani dhe Emini. Në datën **28.07.1998**, forcat serbe së pari e bombarduan fshatin dhe, më pas, depërtuan në lagjen ku ndodhej shtëpia e Dibranit. Emini e luti të atin ta braktiste fshatin së bashku me të, por Dibrani nuk deshi të largohej nga shtëpia e vet. Pas pesë ditësh, më 3.08.1998, kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati, Emini u kthye në shtëpi. E ka gjetur shtëpinë e demoluar dhe të djegur. Afro 50 metra më larg, pranë përrorskës së vogël të fshatit, e ka gjetur trupin e të atit, në të cilin shiheshin plagët e shumta nga plumbat. E ka varrosur në afërsi të atij vendi. Në muajin nëntor të vitit 1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Dibranit në varrezat e fshatit.

Burimi: deklarata E.M, FDH-17321.

Zoran (Marko) Simić

(7.01.1974, serb nga Beogradi, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Zorani me origjinë ka qenë nga Pollomi te Bratunci [BdheH]. Ka marr pjesë në luftën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Pas lufte, punonte si polic ushtarak. U punësua në MPB-në e Serbisë më 1.06.1998. Punonte pranë Shërbimit të Sigurimit, kur edhe kaloi në Beograd. Një muaj më vonë, Zorani ka marr pjesë në luftimet me forcat e UÇK-së në rajonin e *Drenicës/Drenica*. Ka rënë më **29.07.1998** në **Llaushë/Lauša**. E kanë varrosur më 1.08.1998 në varrezat e Bratuncit [BdheH].

Burimet: deklarata Lj.S, FDH-36492; KMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 62; Politika, Zoran Simić, përkujtimi në shtyp, 1.08.1998, FDH-20745; *Serb Forces Embark on Large-Scale Attack in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 27.07.1998, FDH-29378.

Shefqet (Kamer) Shala

(23.06.1975, shqiptar nga Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Shefqeti aderoi në UÇK në muajin prill të vitit 1998. Ka marr pjesë në mbrojtjen e fshatit. Takimet e ushtarëve të UÇK-së mbaheshin në odën e tij në Kopiliqin e

Ulët/Donji Obilić. Në datën **31.07.1998**, ai ka rënë në betejë me forcat serbe, që u zhvillua te udhëkryqi në fshatin **Rezallë të Re/Ljudevik**, pranë pyllit. Familjarët kanë mësuar për vdekjen e tij nga mediat, shtatë ditë më vonë. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë varrosur Shefqetin në ditën e rënies së tij në varrezat e Kopiliqit të Ulët/Donji Obilić. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 1999, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kopiliqin e Ulët/Donji Obilić.

Burimet: deklarata I.S, FDH-32469; J. Martinsen, *Registri..*, FDH-26092.

Sadik (Rrustem) Hoti

(5.08.1958, shqiptar nga Jashanica e Ulët/Donja Jošanica, komuna e Klinës/Klina, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Qamil (Shaban) Hoti

(20.11.1967, shqiptar nga Jashanica e Ulët/Donja Jošanica, komuna e Klinës/Klina, bujk, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Fatmir (Imer) Hoti

(20.02.1974, shqiptar nga Jashanica/Jošanica, komuna e Klinës/Klina, i papunë, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Sadiku, Fatmiri dhe Qamili kanë pësuar më **1.08.1998**, kur forcat serbe e bombarduan **Burojë/Bročna**. Bashkëluftëtarët i kanë varrosur që të tre në varrezat e Vojnikut/Voćnjak. Pas lufte, më 20.10.1999, trupat e tyre janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica [Klinë/Klina].

Burimet: deklarata I.H, FDH-33032; deklarata G.H, FDH-30784; J. Martinsen, *Registri..*, FDH-26092; *Three Albanians Wounded in Serb Attack on Skenderaj Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 31.07.1998, FDH-29387.

Srećko (Obrad) Marjanović

(2.05.1973, serb nga Pauni, komuna e Valjevës, bujk, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Srećko jetonte në bashkësi familjare me prindërit Obradin dhe Zoriken. Familja e punonte tokën dhe ishte ky burimi kryesor i ekzistencës. Pas përfundimit të shërbimit të rregullt ushtarak, Srećko u bë anëtar i